



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE
PA1 Nr.08-103
07.04.2025
Shkup

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 22, dhe në lidhje me nënparagrafin 2 nga neni i njëjtë i Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24 dhe 193/24), neni 121 nga ligji i Procedurës së Përgjithshme Administrative („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“, nr.124/15) dhe neni 42 paragrafi (1) nga Ligji i Kontesteve Administrative („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.96/19), duke vepruar sipas Propozimit PA1 nr.08-103 datë 03.04.2025, për miratim të vendimit për anulimin e Vendimit PA1 nr.08-55 datë 03.03.2025 për heqjen e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare për Veprimtari Radiodifuzive TV SHUTEL SHPKNJP Shkup, PA1 nr.08-18 datë 07.09.2023 („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“, nr.51/25), në pajtim me Konkluzionin, ark.nr.02-1587/2 datë 04.04.2025, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 15-të mbajtur më 04.04.2025 miratoi:

VENDIM

1. **ANULOHET** Vendimi PA1 nr.08-55 datë 03.03.2025 i Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia) për heqjen e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare për Veprimtari Radiodifuzive TV SHUTEL SHPKNJP Shkup, PA1 nr.08-18 datë 07.09.2023, duke pasur parasysh se transmetuesi në tërësi ka mënjanuar shkakun për të cilën Këshilli i Agjencisë ka miratuar vendim, përkatësisht më 02.04.2025, në tërësi ka përmbushur detyrimet financiare në vijim, ndaj Agjencisë, përkatësisht:

- ka paguar faturën nr.2025-100-0011 datë 10.01.2025 (nr. ynë ark.05-137/1 datë 10.01.2025) për kompensim vjetor të lejes për transmetim televiziv për periudhën nga data 05.01.2025 deri më 04.01.2026, në shumë prej 1.240.182,00 (një milion e dyqind e dyzet mijë e njëqind e tetëdhjetë e dy) denarë;

- ka paguar shpenzimet në shumë prej 3.268,00 (tre mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e tetë) denarë, me TVSH, për botimin e Vendimit PA1 nr.08-55 datë 03.03.2025 për heqjen e lejes, në Gazetën Zyrtare të RMV-së nr.51/25 – sipas Faturës nr.2320-6849/27 datë 10.03.2025 (nr.ynë ark.05-1106/1 datë 19.03.2025);

- ka paguar shpenzimet në vlerë të përgjithëshme prej 23.714,00 (njëzet e tre mijë e shtatëqind e katërmëdhjetë) denarë, me TVSH për botimin e Vendimit PA1 nr.08-55 datë 03.03.2025 për heqjen e lejes, në 2 (dy) gazeta ditore, prej të cilave njëra është në gjuhën e bashkësisë joshumicë, por që e flasin së paku 20% e qytetarëve të RMV-së (sipas Faturës në Veçer Pres SHPKNJP Shkup nr.2510300321 datë

05.03.2025 (nr.ynë ark.05-1166/1 datë 21.03.2025) dhe Faturën në Koha Produktion SHPK Shkup nr.36136/2025 datë 18.03.2025 (nr.ynë ark.05-1167/1 datë 21.03.2025);

- ka paguar shpenzimet në shumë prej 1.083,00 (një mijë e tetëdhjetë e tre) denarë, me TVSH për botimin e Aktvendimit për fshirje nga regjistri i transmetuesve PA1 nr.08-83 datë 07.03.2025, në Gazetën Zyrtare të RMV-së, nr.56/25 – sipas Faturës nr.2617-6849/27 datë 14.03.2025 (nr.ynë ark.05-1241/1 datë 24.03.2025);

- ka paguar shpenzimet në shumë prej 3.268,00 (tre mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e tetë) denarë me TVSH, për botimin e këtij Vendimi për anulimin e Vendimit PA1 nr.08-55 datë 03.03.2025 për heqjen e lejes PA1 nr.08-18 datë 07.09.2023 në Gazetën Zyrtare të RMV-së.

2. **DETYROHET** Shoqëria Tregtare për Veprimtari Radiodifuzive TV SHUTEL SHPKNJP Shkup, jo më vonë deri me datë 11.04.2025 të tërheqë Padinë e paraqitur në Gjykatën Administrative të RMV-së, me datë 02.04.2025, kundër Agjencisë, për anulimin e Vendimit PA1 nr.08-55 datë 03.03.2025 për heqjen e lejes PA1 nr.08-18 datë 07.09.2023.

3. Fatura me nr.2025-100-0087 datë 06.03.2025 (nr.ynë ark.05-915/1 datë 06.03.2025) e paraqitur vetëm për periudhën e punës, përkatësisht deri në ditën e miratimit të Vendimit për heqjen e lejes, PA1 nr.08-55 datë 03.03.2025, do të anulohet, dhe Fatura me nr.2025-100-0011 datë 10.01.2025 (nr.ynë ark.05-137/1 datë 10.01.2025) për kompensimin vjetor për lejen e transmetimit televiziv për periudhën nga data 05.01.2025 deri më 04.01.2026, që paraprakisht është ndaluar me Vendimin për heqjen, PA1 nr.08-55 datë 03.03.2025, të cilën transmetuesi e pagoi në tërësi më 02.04.2025, përsëri është e vlefshme.

4. Ky Vendim hyn në fuqi me datë 11.04.2025, me kusht që Shoqëria Tregtare për Veprimtari Radiodifuzive TV SHUTEL SHPKNJP Shkup, jo më vonë se data 11.04.2025 të tërheqë Padinë, e paraqitur në pikën 2 të këtij Vendimi dhe t'i dorëzojë Agjencisë dëshmi.

Nëse transmetuesi, Shoqëria Tregtare për Veprimtari Radiodifuzive TV SHUTEL SHPKNJP Shkup, nuk e përmbush detyrimin e paraqitur në pikën 2 të këtij Vendimi në afatin e caktuar, mbetet në fuqi Vendimi i Këshillit të Agjencisë për heqjen e lejes për transmetim televiziv, PA1 nr.08-55 datë 03.03.2025.

5. Pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, Shoqëria Tregtare për Veprimtari Radiodifuzive TV SHUTEL SHPKNJP Shkup, do të shkruhet në regjistrin e transmetuesve që udhëhiqet nga Agjencia.

6. Ky Vendim publikohet në Gazetën Zyrtare të RMV-së dhe në ueb faqen e Agjencisë.

A r s y e t i m

Këshilli i Agjencisë në seancën e 9-të mbajtur më 28.02.2025, në pajtim me Konkluzionin ark.nr.02-799/7 datë 28.02.2025, miratoi Vendim PA1 nr.08-55 datë 03.03.2025, me të cilin ka hequr lejen për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare për Veprimtari Radiodifuzive TV SHUTEL SHPKNJP Shkup, PA1 nr.08-18 datë 07.09.2023, për shkak se zotëruesi i lejes nuk ka paguar kompensimin vjetor për lejen e transmetimit televiziv në afatin e parashikuar ligjor prej - 30 ditësh nga dita e pranimit të Faturës me nr.2025-100-0011 datë 10.01.2025 (nr.ynë ark.05-137/1 datë 10.01.2025) në shumë prej 1.240.182,00 (një milion e dyqind e dyzet mijë e njëqind e tetëdhjetë e dy) denarë.

Vendimi është botuar në („Gazetën Zyrtare të RMV-së“, nr.51/25). Njëkohësisht, pas miratimit të vendimit në fjalë për heqjen e lejes, Këshilli i Agjencisë në seancën e 10-të mbajtur më 07.03.2025, në pajtim me Konkluzionin ark.nr.02-910/5 datë 07.03.2025, miratoi Aktvendim, PA1 nr.08-83 datë 07.03.2025, me të cilin Shoqëria Tregtare për Veprimtari Radiodifuzive TV SHUTEL SHPKNJP Shkup është fshirë nga regjistri i transmetuesve që udhëhiqet nga Agjencia.

Me datë 03.04.2025, drejtuar Drejtorit të Agjencisë, dr. Zoran Trajčevski nga Sektori për financa dhe logjistikë është dorëzuar Njoftim ark.nr.05-661/2 datë 03.04.2025, ku Shoqëria Tregtare për Veprimtari Radiodifuzive TV SHUTEL SHPKNJP Shkup pas marrjes së Vendimit PA1 nr.08-55 datë 03.03.2025 për heqjen e lejes për transmetim televiziv më 02.04.2025 ka kryer pagesën e kompensimit vjetor për lejen e transmetimit televiziv, si dhe ka paguar në tërësi shpenzimet që lindin (rrjedhin) nga procedura për kthimin e lejes. Në bazë të njoftimit në fjalë është konstatuar se transmetuesi në tërësi ka përmbushur detyrimet financiare ndaj Agjencisë, të paraqitura në pikën 1 të këtij Vendimi.

Gjithashtu, më 03.04.2025, drejtuar Agjencisë nga Shoqëria Tregtare për Veprimtari Radiodifuzive TV SHUTEL SHPKNJP Shkup është dorëzuar Kërkesë për kthimin e lejes për transmetim të programit televiziv, i ynë PA1 nr.08-103 datë 03.04.2025, me shtojcë bashkëngjitje nga Padia, paraqitur para Gjykatës Administrative të RMV-së më 02.04.2025, kundër Vendimit për heqjen e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare për Veprimtari Radiodifuzive TV SHUTEL SHPKNJP Shkup, me vullë pranuese nga Gjykata Administrative e RMV-së nga 02.04.2025.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, Fatura me nr. 2025-100-0087 datë 06.03.2025 (nr.ynë ark.05-915/1 datë 06.03.2025) e cila i referohet vetëm periudhës së punës, përkatësisht deri në ditën e miratimit të Vendimit PA1 nr.08-55 datë 03.03.2025 për heqjen e lejes, PA1 nr.08-18 datë 07.09.2023, aulohet dhe Fatura me nr.2025-100-0011 datë 10.01.2025 (nr.ynë ark.05-137/1 datë 10.01.2025) për kompensim vjetor për lejen e transmetimit televiziv për periudhën nga data 05.01.2025 deri më 04.01.2026, që paraprakisht është anuluar me Vendimin për heqjen, PA1 nr.08-55 datë 03.03.2025, të cilën transmetuesi e ka paguar në tërësi më 02.04.2025, përsëri është e vlefshme.

Në pajtim me mundësinë ligjore përcaktuar në nenin 121 nga Ligji i Procedurës së Përgjithshme Administrative dhe neni 42 paragrafi (1) nga Ligji i Kontesteve Administrative, Shoqëria Tregtare për Veprimtari Radiodifuzive TV SHUTEL SHPKNJP Shkup, jo më vonë se data 11.04.2025 duhet të tërheqë Padinë e paraqitur në Gjykatës Administrative të RMV-së, më 02.04.2025 kundër Agjencisë, paraqitur në pikën 2 të këtij Vendimi dhe të dorëzojë dëshmi para Agjencisë.

Nëse transmetuesi, Shoqëria Tregtare për Veprimtari Radiodifuzive TV SHUTEL SHPKNJP Shkup, nuk e përmbush detyrimin e paraqitur në pikën 2 të këtij Vendimi në afatin e caktuar, mbetet në fuqi Vendimi i Këshillit të Agjencisë PA1 nr.08-55 datë 03.03.2025, për heqjen e lejes për transmetim televiziv, PA1 nr.08-18 datë 07.09.2023.

Duke pasur parasysh se Shoqëria Tregtare për Veprimtari Radiodifuzive TV SHUTEL SHPKNJP Shkup, me pagesën e datës 02.04.2025, në tërësi ka paguar kompensimin vjetor për lejen e transmetimit televiziv për periudhën nga data 05.01.2025 deri më 04.01.2026, si dhe ka shlyer të gjitha detyrimet financiare ndaj Agjencisë që kanë lindur (rrjedhur) pas miratimit të Vendimit PA1 nr.08-55 datë 03.03.2025 për heqjen e lejes për transmetim televiziv, PA1 nr.08-18 datë 07.09.2023, në pajtim me Njoftimin nga Sektori për financa dhe logjistikë ark.nr.05-661/2 datë 03.04.2025, konsiderohet se Shoqëria Tregtare për Veprimtari Radiodifuzive TV SHUTEL SHPKNJP Shkup, në tërësi ka mënjanuar shkakun për të cilin Këshilli i Agjencisë miratoi Vendimin për heqjen e lejes PA1 nr.08-55 datë 03.03.2025.

Në pajtim me nenin 121 nga Ligji i Procedurës së Përgjithshme Administrative dhe neni 42 paragrafi (1) nga Ligji i Kontesteve Administrative, Këshilli i Agjencisë

miratoi Propozimin PA1 nr.08-103 datë 03.04.2025 për miratimin e vendimit për anulimin e Vendimit PA1 nr.08-55 datë 03.03.2025, për heqjen e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare për Veprimtari Radiodifuzive TV SHUTEL SHPKNJP Shkup PA1 nr.08-18 datë 07.09.2023 dhe në seancën e 15-të mbajtur më 04.04.2025 në pajtim me Konkluzionin ark.nr.02-1587/2 datë 04.04.2025, miratoi Vendim me qasje ndaj anulimit të Vendimit PA1 nr.08-55 datë 03.03.2025 të Këshillit të Agjencisë për heqjen e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare për Veprimtari Radiodifuzive TV SHUTEL SHPKNJP Shkup PA1 nr.08-18 datë 07.09.2023.

Në pajtim me nenin 24 të LSHMAAV, ky Vendim është përfundimtar, dhe kundër këtij vendimi mund të paraqite padi për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të vendimit.

Bazuar në sa më sipër u miratua Vendim si në dispozitiv.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,**

Lazo PETRUSHEVSKI, d.v

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, Shoqëria Tregtare për Veprimtari Radiodifuzive TV SHUTEL SHPKNJP Shkup, ka të drejtë të paraqesë padi për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të vendimit.